

## **SHPLLJE QYTETARE**

### **Qytetarët kërkojnë shoqëri të lirë dhe drejtësi sociale**

#### **Liria është më e rëndësishme për shoqërinë qytetare!**

Gjendja në shtetin tonë tregon që shoqëria qytetare nuk ekziston pa lirinë. Andaj, kur në këtë vend është shkelur e drejta themelore e njeriut – liria, për atë duhet vazhdimisht të flitet dhe debatohet. Në këtë debate vazhdimisht dhe në mënyrë aktive duhet të marrin pjesë qytetarët, individualisht dhe me anë të organizatave qytetare, duke u përballuar me të fuqishmit politik me kërkesat e të pakënaqurve dhe argumentet e kundërshtarëve. Në Maqedoni u krijua një masë kritike e qytetarëve që kanë ndërmend të përzihen në politikë, lirshëm të ngritën dhe të kërkojnë jetesë më të mirë pa mos pësuar konsekuencat.

Në debatin e vazhdueshëm për lirinë, që duhet të kthejë besimin në shoqërinë qytetare të themeluar në bazë të mundësive të barabarta për gjithë dhe në çdo kohë, bashkohen tre parime: e drejta e barazisë së ndryshimeve, e drejta e shprehjes së lirë të mendimit edhe kur shumica nuk pajtohen me ty dhe e drejta e kundërshtimit të autoriteteve dhe personave të fuqishme duke vënë në pyetje vendimet e tyre, politikat dhe sjelljet.

Vendosja në praktikë të parimeve të lirisë duhet të inkorporohet në sistemin arsimor me anë të mësimëve të lirive qytetare. Ashtu do të krijohen gjeneratat e ardhshme të qytetarëve aktiv dhe solidar që do të pranojnë këto parime si të drejta të tyre themelore të njeriut. Kjo gjeneratë ka rol historik për të dhënë mundësinë e brezave të ardhshme të praktikojnë të drejtat e qytetarëve të lirë për të paralajmëruar që nuk do të jenë vetëm të nënshtruar pa zë, por qytetarë “kokë lartë” kur bëhet fjalë për mbrojtjen e interesit publik.

#### **Si të lirohet shteti i robëruar?**

Situata në të cilën gjendet për momentin shoqëria në vendin tonë, kërkon fillimin e një procesi të gjatë dhe të domosdoshëm për lirinë e institucioneve të robëruar, gjegjësisht shoqërinë. Gjendja në të cilën e kanë sjellë elitat politike të cilët udhëzoheshin vetëm nga interesat partiake dhe personale. Gjendja për të cilën interesi publik është ndryshuar me atë partiak. Si qytetarë të këtij shteti të robëruar kemi humbur definicionin e kufirit për atë se çfarë është e sjellje e pranueshme nga ana e pushtetit. Hapi i parë drejt liritë të shtetit është ri-vendosja e detyrueshme e këtij kufiri, nga ana e qytetarëve, për atë se cila është vija e kuqe e sjelljes së pranueshme e çdo pushteti.

Elitat politike duhet të japin kontributin e tyre për të kthyer esencën institucioneve si shërbim dhe mbrojtës së interesave publike të gjitha strukturave qytetare. Sundimi i të drejtës dhe reciprociteti duhet të jenë parime themelore të kësaj lëvizje, sepse pa atë nuk mund të ketë progres në asnjë fushë tjetër. Shoqëria qytetare duhet të mbështet institucionet (dhe individët në ato institucione) për të cilat ka gjasa që mund të ndjekin korrupsionin dhe të çmontojnë “shtetin e robëruar”.

#### **Pjesëmarrje efektive qytetare për më tepër liri dhe demokraci!**

Qytetarëve ju nevojitet pjesëmarrje më efektive qytetare. Për këtë është e nevojshme të bëhen ndryshime themelore të gjitha ligjeve që rregullojnë pjesëmarrjen qytetare ose vetë-organizimin duke filluar me uljen e pragjeve që rrallë arrihen për shpalljen e referendumit për

iniciative qytetare, iniciative ligjore, regjistrim të partisë politike ose kandidaturë në listë të pavarur, dhe deri në pluralizmin, liberalizimin dhe njohjen e formave të ndryshme të organizimit dhe përfaqësimit, veprimit sindikal ose çfarëdo artikulimit të interesit publik.

Çelësi për iniciativa të suksesshme qytetare qëndron në rrjetëzimin e qytetarëve dhe organizatave qytetare me anë të cilave aksionet e tyre do të marrin më tepër legjitimitet, me respektimin e llojllojshmërisë së qëndrimeve dhe taktikave të veprimit por me një qëllim të përbashkët – ndryshim pozitiv shoqëror.

Të rinjtë aktiv tregojnë më tepër vetëbesim, sepse institucionet duhet të sigurojnë kushte dhe mbështetje për veprim dhe vetë-organizim – hapësira publike, zyra për të rinjtë, mjete financiare dhe gatishmëri për bashkëpunim. Duhet të sigurohen kushte për pjesëmarrje të shoqërisë qytetare në proceset e krijimit të politikave për të rinj dhe gatishmëri për përfaqësori në tyre për të parandaluar vendimet e gabuara. Të rinjtë duhet detyrimisht t'ju mundësohet pjesëmarrje të pandërprerë në trupat për organizim studentor dhe shkollor dhe përfaqësim.

### **Zgjedhjet nuk janë qëllimi ynë, ardhmëria është qëllimi ynë !**

Për të qenë zgjedhjet të drejta dhe demokratike duhet para së gjithashtu reformë themelore të Komisionit Shtetëror Zgjedhor, pastrim të Listës Zgjedhore, revizion të Kodit Zgjedhor, departizim dhe profesionalizim të Gjykatës Kushtetuese dhe Drejtuese, vazhdim të afatit për zgjedhje deri sa nuk zgjidhen problemet kryesore dhe zhvillimin e zgjedhjeve atëherë kur do të ketë kushte për atë. Gjithashtu, duhet të hapet çështja e përgjegjësisë ose të drejtës për pjesëmarrje në zgjedhje si kandidatë të atyre personave që është provuar që kanë bërë vepra kriminale me zgjedhjet dhe votimin ose janë të paditur për atë.

Përveç kësaj, qytetarët kanë të drejtë të hapet diskutim për ndryshim të modelit zgjedhor dhe gjitha çështjet që do të mundësojnë më tepër demokraci.

### **Mediet janë element kryesor të shoqërisë së lirë!**

Roli i organizatave qytetare dhe të qytetarëve është të vazhdojnë betejën për çlirimin e sferës mediatike të shtypur me forcë dhe me korrupsion në favor të elitave politike në pushtet dhe në favor të interesave të tyre partiake.

Nga këndvështrimi i vëmendjes qytetare asnjëherë nuk duhet të humbet roli i medieve si bazë për mbrojtjen e interesit publik. Ky rol fillimisht duhet t'i kthehet Radio Televizionit të Maqedonisë sepse RTVM është themeluar nga qytetarët dhe për qytetarët. Reformat aktuale ose vijuese nuk do të kenë asnjë qëllim dhe thelb nëse qytetarët nuk njohin rezultate që garantojnë servis publik të medieve në interes të qytetarëve.

Kjo duhet të arrihet edhe me trupat rregullator mediatik. Nga rolet dhe kapacitetet e tyre të reja duhet të dalin edhe masat me të cilat do të zgjidhen problemet siç janë klientët e medieve, si dhe besimi në profesionin e gazetarisë.

Kur bëhet fjalë për profesionin, gazetarët dhe shoqatat e tyre janë të parët, që duhet të njohin që ciceroni i tyre kryesor është interesi publik, gjegjësisht interesi i qytetarëve dhe e vërteta nga e cila nuk do të dorëzohen asnjëherë dhe për të cilën kërkojnë çdoherë dhe pa dallim nga kërcënimet mbi ata.

## **Korrupsioni dhe varfëria shkojnë paralel!**

Në një ambient në të cilën korrupsioni është në nivel të lartë si një problem shoqëror, dhe në nivel më të ultë dhe më të lartë, patjetër duhet të inkurajohen qytetarët të paraqesin, por edhe të nderohet dhe përforcohet vetëdija për “çmimin shoqëror” të korrupsionit dhe të mbështeten institucionet të cilat mund të sjellin dhe të bëjnë ndryshime. Nga korrupsioni përfitojnë të fuqishmit dhe të pasurit, ndërsa humbin të dobëtit dhe të varfrit. Andaj, lufta kundër korrupsionit është luftë PËR drejtësi sociale!

Korrupsioni dhe varfëria shkojnë paralel. Maqedonia është një vend në të cilën 10 për qind të popullatës jeton në varfëri ekstreme dhe pothuaj se 30 për qind janë nën linjën e varfërisë. Shteti, me anë të mekanizmave të tyre, duhet të sigurojë më tepër të holla për ndihmë sociale por edhe në mënyrë të saktë të adresojë tek personat që kanë më tepër nevojë.

## **Drejtësi sociale dhe solidaritet si masë për avancimi ne shoqërisë!**

Varfëria, diskriminimi, pabarazia dhe mungesa e reciprocitetit janë problem që e ndejnë shumica e njerëzve në shtet ndonëse Maqedonia është përcaktuar me kushtetutë si një shtet social. Solidariteti si vlefshmëri duhet të promovohet dhe kujdeset në shoqëri, si nga shteti ashtu edhe nga qytetarët. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, veçanërisht të drejtat e kategorive të personave të jo-privilegjuar duhet të marrin më tepër rëndësi dhe prioritet. Ndihma sociale duhet të jepet personave më të rrezikuar, varfër dhe të moshuar, ndërsa shuma duhet të sigurojë një jetë minimale dinjitoze. Të varfrit duhet të kenë qasje në ndihmë juridike falas. Të diskriminuarve duhet të ju mundësohet ndihmë përkatëse dhe me kohë, mbështete dhe mbrojtje. Shoqëria jonë duhet të ketë kujdes edhe për barazinë e inter-gjeneratave dhe intra-gjeneratave.

Gatishmëria, pranueshmëria dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore dhe qasja në ato duhet të jetë një temë që seriozisht do të debatohet në shoqërinë. Secili person duhet të ketë qasje në shërbime cilësore shëndetësore.

## **Buxheti qytetar – ata që mbushin buxhetin duhet të tregojnë si duhet të harxhohet!**

Secila politikë, gjegjësisht vendim për shpenzimin e të hollave popullore duhet të jetë në mënyrë transparente, me përfshirjen e qytetarëve në krijimin e buxheteve lokale dhe të buxhetit qendror, por edhe me prezantimi ne obligimit për buxhet qytetar – si masë për transparencë dhe përfshirje të qytetarisë në mënyrën si pushteti shpenzon të hollat. Transparenca e rritur në kohën e njëjtë është një filtër për shpenzimin e papërgjegjshëm dhe jo-produkti të disa miliardëve euro në vit, të holla të qytetarëve dhe biznesit.

Duhet të sistem transparent i konsultimeve, duke filluar nga procesi i përgatitjes deri në miratimin e fundit të politikave publike si dhe përgatitja e rregullt dhe publikimi i informacioneve me karakter publik. Në këtë mënyrë do të rritet transparenca dhe përgjegjshmëria gjatë shpenzimit të të hollave publike por edhe të marrjes së borxhit që do të kthejnë gjeneratat e ardhshme. Ata që mbushin buxhetin kanë të drejtë të vendosin si do të harxhohet. Ndarja dhe shpenzimi i të hollave publike nuk guxon dhe nuk duhet të varet nga vullneti i strukturave në pushtet. Maqedonia duhet të braktis zonën e “errësirës fiskale”.

## **Punësime më cilësore për jetesë më të mirë!**

Në periudhë prej 21 viteve, përqindja mesatare e rritjes ekonomike është vetëm 1.5%. Maqedonia ka arritur të dorëzojë përqindje pozitive të rritjes, por të pamjaftueshme për të përmirësuar standardin e jetës. Politikat duhet të drejtohen drejt zgjidhjeve të qëndrueshme që do të mundësojnë rritjen ekonomike dhe do të zvogëlojnë papunësinë në të vërtetë.

Të rinjtë janë një prej grupeve më të marginalizuar. Më tepër se gjysma planifikojnë të braktisin shtetin, të pakënaqur nga papunësia e madhe dhe pjesa më e gjerë kërkojnë dalje në punësimet në administratë publike, të shtypur nga kushtet në të cilat jetojnë dhe arsimohen dhe varen nga prindërit e tyre.

Duhet një investim në arsim që do të krijojë qytetarë aktiv, në vend të ndarjeve, në të cilën do të respektohen të drejtat e nxënësve dhe studentëve. Me rëndësi është të përmirësohet cilësia e arsimit, ndërsa të rinjtë të aftësohen të zbatojnë njohuritë e tyre në tregun e punës. Si një pjesë e pandarë e kësaj cilësie duhet në mënyrë serioze të investohet edhe në shkolla të mira, fakultete, konvikte për studentë, biblioteka, laboratorë, etj.